



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVO
REPUBLIKA KOSOVA

KOMUNA E PEJËS MUNICIPALITY OF PEJA OPŠTINA PEĆ



KUVENDI I KOMUNËS SË PEJES

I.Numër:463-01/30002, dt. 29 Maj 2026

Në bazë të nenit 12 par.2 pika d) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr. 03/L-40 të datës 20 shkurt 2008 në mbështetje të nenit 18 të Ligjit nr. 06/L-092 mbi dhënjën në shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës Komunale, nenit 18 të rregullores (QRK) Nr.09/2020 për përcaktimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës si dhe nenit 20 paragrafi 1 pika 1.4 të Statutit Nr.01/2020 të Komunës së Pejës, I. Numër: 01-016/01-413431.dt.30. shtator 2020, pasi shqyrtoj propozimin e Kryetarit të Komunës, me rekomandim të Komitetit për Politikë dhe Financa, Kuvendi Komunal Pejë, në takimin e mbajtur me datë: 29 Maj 2026, merr këtë:

VENDIM

Nr. 33/2026

Mbi formimin e Komisionit të Ankesave të palëve në procedurën e dhënies në shfrytëzim afat shkurtër dhe afatgjatë të pronës së paluajtshme komunale

1. **MIRATOHET**- Vendimi për formimin e komisionit të ankesave për shqyrtimin e ankesave të palëve në procedurën e dhënies në shfrytëzim afat shkurtër dhe afatgjatë të pronës së paluajtshme të Komunës.
2. Komisioni ankesave sipas këtij vendimi përbehet prej 5 (pesë) anëtarëve si me poshtë:
 - 2.1. Shqiprim Muriqi - anëtarë i kuvendit nga subjekti i LDK-së,
 - 2.2. Leotrim Murtezaj - anëtarë i kuvendit nga subjekti PDK-së,
 - 2.3. Albi Shala - anëtarë nga ekzekutivi i komunës – Drejtor në Drejtorinë për Punë Inspektuese.
 - 2.4. Nita Panduri Mullarama - anëtare nga ekzekutivi i komunës – Drejtoreshë në Drejtorinë për Administratë
 - 2.5. _____ anëtarë nga sektori joqeveritar anëtarë.
3. Kryesuesi i Komisionit të Ankesave zgjidhet me shumicë votash nga radhët e anëtarëve të Komisionit.
4. Mandati i Komisionit të Ankesave është dy (2) vite brenda mandatit të Kuvendit të Komunës.
5. Detyrë dhe përgjegjësi e Komisionit ankesave është:
 - 5.1 Pranimin i ankesave të paraqitura në vlerësimin e ofertave,
 - 5.2 Shqyrtimi i ankesave,
 - 5.2 Njoftimi mbi vendimin e marrë të kryesuesit dhe kryetarit të komunës.
6. Administrata e Komunës i jep përkrahje komisionit të ankesave sipas kërkesës se tyre.
7. Për zbatimin e këtij Vendimi kujdeset Kryetari i Komunës.
8. Ky vendim shpallet tridhjetë (30) ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokollit të Ministrisë për Administrimin e Pushtetit Lokal dhe hynë në fuqi shtatë (7) ditë pas publikimit në gjuhë zyrtare në web-faqen e Komunës së Pejës.

Vendimi ti dërgohet:

MAPL-së,
Kryetarit të Komunës,
DÇPJ,
Arkiv.



KRYESUESI I KUVENDIT
z. Rexhep Kurtbogaj